

INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL
FOR THE FORMER YUGOSLAVIACHURCHILLPLEIN 1, P.O. BOX 13888
2501 EW THE HAGUE, THE NETHERLANDS
TELEPHONE: +31 70 416 5326
FAX: +31 70 416 5307TRIBUNAL PÉNAL INTERNATIONAL
POUR L'EX-YOUGOSLAVIECHURCHILLPLEIN 1, B.P. 13888
2501 EW LA HAYE, PAYS-BAS
TELEPHONE: +31 70 416 5326
FAX: +31 70 416 5307

Lënda Nr. IT-04-84-R77.1
Prokurori k. Shefqet Kabashit

PUBLIK**VENDIM MBI CAKTIMIN E AVOKATIT KUJDESTAR****SEKRETARI,**

DUKE MARRË SHËNIM Statutin e Tribunalit të miratuar nga Këshilli i Sigurimit në bazë të Rezolutës 827 (1993), me ndryshime të mëvonshme (“Statuti”) dhe në veçanti Nenin 21 të tij;

DUKE MARRË SHËNIM Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Tribunali më 11 shkurt 1994, dhe me ndryshime të mëvonshme (“Rregullorja”), dhe në veçanti Rregullat 44, 45, 62(B) dhe 77 të saj;

DUKE MARRË SHËNIM Direktivën për Emërimin e Avokatëve të Mbrojtjes të miratuar prej Tribunalit më 28 korrik 1994, me ndryshime të mëvonshme (“Direktiva”) dhe në veçanti Nenet 14(B) dhe 16(H) të saj;

DUKE MARRË SHËNIM Kodin e Sjelljes Profesionale për Avokatët që Dalin Para Tribunalit Ndërkombëtar (IT/125 REV.3);

DUKE MARRË SHËNIM se më 5 qershor 2007, u paraqit një Urdhër në Vend të Aktakuzës kundër Z. Shefqet Kabashi (“I Akuzuari”), ku ai akuzohet për shpërfillje të Tribunalit sipas Rregullës 77 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM se më 18 shkurt 2008, Urdhri në Vend të Aktakuzës u ndryshua nëpërmjet “Vendim për Lejimin e Ndryshimit të Aktakuzës”;

DUKE MARRË PARASYSH se i Akuzuari u transferua në selinë e Tribunalit më 18 gusht 2011 dhe se paraqitja e tij e parë do të kryhet në përputhje me Rregullën 62 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM se Rregullat nga kapitulli 4 deri në kapitullin 8 zbatohen *mutatis mutandis* në lidhje me procedura që mbulohen prej Rregullës 77 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM se kushdo që akuzohet për shpërfillje të Tribunalit ka të drejtë t'i caktohet avokat në përputhje me Rregullën 45 të Rregullores në qoftë se plotëson kriteret në përcaktimin e nivelit të varfërisë;

DUKE MARRË PARASYSH se të drejtat e të Akuzuarit në bazë të Statutit, Rregullores dhe Direktivës duhet të jenë të garantuara deri kur ai të punësojë avokat të përherëshëm, ose t'i caktohet avokat sipas Rregullës 45 të Rregullores dhe se Rregulla 62(B) e Rregullores i mundëson Sekretarit të caktojë një avokat kujdestar për këtë qëllim;

DUKE MARRË PARASYSH se I Akuzuari është informuar për të drejtën e tij që të marrë avokat ose që Sekretari t'i caktojë avokat në qoftë se atij i mungojnë fondet për pagesën e avokatit, dhe ka dhënë pëlqimin për caktimin e avokatit kujdestar të përkohshëm;

DUKE MARRË PARASYSH se Z. Michael Karnavas, avokat nga Shtetet e Bashkuara, është në listën e “avokatëve kujdestarë” parashikuar në Rregullën 45(C) të Rregullores, dhe ka bërë të ditur se është i gatshëm ta përfaqësojë të Akuzuarin si avokat kujdestar;

VENDOS që, bazuar në Nenin 16(H) të Direktivës, ta emërojë Z. Karnavas si avokat kujdestar për përfaqësimin e të Akuzuarit në paraqitjen e tij të parë, dhe për çfarëdo nevoje tjetër të mundshme, deri kur i Akuzuari të punësojë një avokat të përherëshëm ose t'i caktohet avokat nga Sekretari, në fuqi që prej datës së këtij vendimi.

/nënshkrim/
John Hocking
Sekretar

Sot më 18 gusht 2011
Në Hagë
Holandë